



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

VENDIM

Nr. 380, Datë 31.08.2021

“Për hapjen e procesit të votimit për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023)”

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, pikën 4, të Nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, si dhe Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar;

V E N D O S A:

1. Procesi i votimit për anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve me mandat ligjor (Shtator 2021-Shtator 2023), fillon në datën 1 Shtator 2021, ora 08.00 dhe mbaron në datën 10 Shtator 2021, ora 14.00.
2. Në procesin e votimit kanë të drejtë të marrin pjesë kineastët votues që janë regjistruar si të tillë brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 309 Prot., datë 30.06.2021, si dhe janë pajisur me krendencialet e votimit.
3. Kineastët votues do të përzgjedhin pesë anëtarë të Këshillit të Miratimit të Projekteve sipas preferencave të tyre, tre duhet të jenë shtetas të huaj dhe dy duhet të jenë shtetas shqiptarë. Përzgjedhja do të bëhet ndërmjet këtyre kandidaturave:
 - Shtetas shqiptarë (renditja sipas rendit alfabetik):
 - Bashkim Hoxha, skenarist;
 - Gazmend Leka, regjisor;
 - Vjollca Dedei, producente;
 - Ylljet Aliçka, skenarist, regjisor.

○ Shtetas të huaj, (renditja sipas rendit alfabetik):

- Ales Pavlin, Slloveni, producent;
- David Pope, Britani e Madhe, skenarist, këshillues skenari;
- Johannes Naber, Gjermani, producent; regjisor, skenarist;
- Karin Howard, Shtetet e Bashkuara të Amerikës; skenariste, producente;
- Nino Kirtadze, Gjeorgji, regjisore;
- Pavlina Jeleva, Bullgare, producente, skenariste.

3. Pas përfundimit të afatit të votimit, do të ndiqen procedurat e shpalljes së Këshillit të Miratimit të Projekteve, konform përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, të ndryshuar.

4. Ngarkohet Drejtoria e Projekteve të zbatojë këtë Vendim, i cili hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Eduart MAKRI

